VENDIM
Nr. 9, datë 21.1.2022

MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË "BREÇANI R.O.S.P." SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA HEC "DRITA" ME KAPACITET TË INSTALUAR 1980 kw

(Ndryshuar me vendimin nr.232, datë 12.9.2022)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa "a", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, si dhe të neneve 4, pika 1, germa "a", 5, pika 1, germa "a" dhe nenit 13, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, dhe nenit 15, të "Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.1.2022, mbasi shqyrtoi relacionet e përgatitura nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes nr. 164/9 prot., datë 11.1.2022 dhe nr. 164/9-1 prot., datë 18.1.2022, "Mbi licencimin e shoqërisë 'Breçani R.O.S.P.' sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC 'Drita' me kapacitet të instaluar 1980 kw",

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 260, datë 21.12.2021, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë "Breçani R.O.S.P." sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për një afat 30-vjeçar.

Në vijim të kësaj vendimmarrjeje, ERE, me shkresën nr. 6/30 prot., datë 22.12.2021, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 7.1.2022), nuk rezultoi të kishte të tilla. Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t'u pajisur me licencë nga ERE, në zbatim të aneksit A, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar.

- Më datë 6.1.2022, u zhvillua një seancë dëgjimore me shoqërinë "Breçani R.O.S.P." sh.p.k., ku u qartësua/sqarua mungesa e pjesshme apo e munguar e dokumentacionit të konstatuar si i tillë nga ERE. Në seancë nga subjekti u bë me dije se ndërtimi i HEC ka përfunduar, janë kryer testimet dhe kolaudimi dhe pret fillimin e operimit. Duke qenë se subjekti ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar nga "Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", e ndryshuar, ka përfunduar punimet e veprës dhe ka parashikuar të fillojë punë në 6 ditët e para të janarit 2022, (pavarësisht se për këtë afat ka qenë e pamundur të merrej një vendim përfundimtar, për arsye se ishte parashikuar dhe seanca përkatëse me subjektin), është vlerësuar që të vijohet me licencimin e shoqërisë.

- Nga analiza që iu bë dokumentacionit, në fazën përfundimtare të procedurave të licencimit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, për shoqërinë "Breçani R.O.S.P." sh.p.k., rezulton se subjekti plotëson tërësisht kërkesat e "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, si më poshtë:

- formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, germat: "a", "b", "c", plotësuar;

- dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor, neni 9, pika 2, germat: "a", "b", "c", "d", "e", "f", "g", plotësuar;

- dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germat: "a", "b", "c", "d", plotësuar;

- dokumentacioni teknik për HEC, neni 9, pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.3, germat: "a", "b", "c", "d"; pika 4.1.4, germat: "a", "b", "c", "d", "e", plotësuar;

- leje nga institucione të tjera, neni 9, pika 4.1.5, germat: "a", "b", "c", plotësuar.

- Shoqëria "Breçani R.O.S.P." sh.p.k. të paraqesë në ERE, çdo vit, rinovimin e kontratës nr. 2693/5 prot., datë 18.7.2018, të lidhur ndërmjet Bashkisë Tropojë, në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërisë "Breçani RO.S.P." sh.p.k. në cilësinë e qiramarrësit, në zbatim të nenit 3, pika 1, e kontratës së qirasë e cila orienton afatin 10-vjeçar të kontratës së qirasë me të drejtë rinovimi çdo vit.

- Në përfundim të afatit të vlefshmërisë së lejes për përdorimin e burimit ujor (data 10.12.2023), shoqëria duhet të depozitojë lejen e rinovuar për përdorimin e burimit ujor në ERE, jo më vonë se një muaj pas rinovimit të saj.

- Shoqëria "Breçani R.O.S.P." sh.p.k. duhet të depozitojë në ERE certifikatën e pronësisë për tokën shtet, me kartelën shoqëruese, me shënimin përkatës për zonën që do të jetë në përdorim të shoqërisë, për ushtrimin e veprimtarisë së HEC "Dritës", jo më vonë se një muaj nga pajisja me këtë dokument.

- Sa i takon provave të reja apo objeksioneve të mundshme që mund të kenë palë të treta në lidhje me këtë proces, kjo është e adresuar në dispozitivin e këtij vendimi, ashtu si dhe plotësimi/mosplotësimi i kushteve të vendosura në këtë dispozitiv.

- Sikurse kemi cituar edhe më sipër, kontrata nr. 98 rep., nr. 24/3 kol., datë 16.1.2019, "Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit 'Drita' me kapacitet 1.980 mw, në lumin e Gashit, degë e lumit Valbonë, Bashkia Tropojë, qarku Kukës", lidhur midis MIE-s dhe mbajtësit të miratimit, shoqërisë "Breçani R.O.S.P." sh.p.k., ka një afat 49-vjeçar, por nga ana tjetër shpjegojmë se ERE, në zbatim të nenit 38, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe nenit 5, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, nuk mund të japë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike një licencë me afat më të madh se 30 vjet.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Breçani R.O.S.P." sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC "Drita", me kapacitet të instaluar 1980 kw, për një afat 30-vjeçar.

2. *Shoqëria "Breçani R.O.S.P." sh.p.k. duhet të paraqesë në ERE kontratën nr. 2693/5 prot., datë 18.7.2018, të rinovuar, apo çdo dokument tjetër që i shërben realizmit të saj brenda 30 ditëve pune nga marrja dijeni.*

3. Shoqëria "Breçani R.O.S.P." sh.p.k., në përfundim të afatit të vlefshmërisë së lejes për përdorimin e burimit ujor (data 10.12.2023), duhet ta depozitojë atë në ERE, jo më vonë se një muaj pas rinovimit.

4. Shoqëria "Breçani R.O.S.P." sh.p.k. të depozitojë në ERE certifikatën e pronësisë për tokën shtet, me kartelën shoqëruese, me shënimin përkatës për zonën që do të jetë në përdorim të shoqërisë, për ushtrimin e veprimtarisë së HEC "Drita", jo më vonë se një muaj nga pajisja me këtë dokument.

5. Ky vendim është objekt rishikimi nga Bordi i ERE-s, sipas përcaktimeve të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të përcaktuara në pikat 2, 3 dhe 4, të këtij vendimi.

6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit, në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti